

**PHILIPS**

CoolPlay

TAKH402



# Manuali i përdoruesit

Regjistroni produktin dhe merrni mbështetje në  
[www.philips.com/support](http://www.philips.com/support)

# Përmbajtja

---

1	Udhëzime të rëndësishme sigurie	2
	Siguria e dëgjimit	2
	Informacion i përgjithshëm	2
2	Kufjet tuaja me Bluetooth	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Pajisje të tjera	3
	Përmbledhje e kufjeve me Bluetooth	3
3	Fillimi	4
	Karikimi i kufjeve	4
	Çiftoni kufjet me telefonin celular	5
4	Përdorimi i kufjeve	5
	Lidhni përsëri kufjet me një pajisje me Bluetooth	5
	Kontrollimi i telefonatave dhe muzikës	5
	Vendosja e kufjeve	6
5	Të dhënat teknike	7
6	Njoftim	8
	Deklarata e pajtueshmërisë	8
	Hedhja e produktit të vjetër dhe bateria	8
	Përputhshmëria me EMF-në	8
	Markat tregtare	9
7	Pyetjet më të shpeshta	10

# 1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

## Siguria e dëgjimit



### Rrezik

- Për të mos dëmtuar dëgjimin, kufizoni kohën që i përdorni kufjet me volum të lartë, dhe uleni volumin në një nivel të sigurt. Sa më i lartë të jetë volumi, aq më e shkurtër të jetë koha e dëgjimit

Sigurohuni të ndiqni udhëzimet e mëposhtme kur përdorni kufjet.

- Dëgjoni në volume të arsyeshme për periudhave kohore të arsyeshme.
- Kujdes të mos rregulloni vazhdimisht volumin lart pasi të dëgjuarit tuaj përshtatet.
- Mos e ngrini volumin kaq shumë sa që të mos dëgjoni çfarë ka rreth jush.
- Ju duhet të përdorni kujdes ose të ndërpritni përkohësisht përdorimin në situatave të mundshme të rrezikshme.
- Presioni i tepërt i tingullit nga kufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.
- Përdorimi i kufjeve me të dy veshët e mbuluar gjatë drejtimit të automjetit nuk rekomandohet dhe mund të jetë i jashtëligjshëm në disa zona.
- Për sigurinë tuaj, shmangni shpërqendrimet nga muzika ose telefonatat ndërsa jeni në trafik ose në mjedise të mundshme të rrezikshme

## Informacion i përgjithshëm

Për të shmangur dëmtimin ose keqfunksionimin



### Kujdes

- Mos i ekspozoni kufjet në nxehtësi ekstreme.
- Mos i rrëzoni kufjet.
- Kufjet nuk duhet të ekspozohen ndaj spërkatjeve ose lëngjeve.
- Mos lejoni që kufjet të zhyten në ujë.
- Mos përdorni agjentë pastrimi që përmbajnë alkool, amoniak, benzinë, ose gërryes.
- Nëse nevojitet pastrim përdorni një leckë të butë, nëse është e nevojshme me një sasi të ulët uji ose sapun të butë të shkrirë, për të pastruar produktin.
- Bateria e integruar nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së tepërt siç është drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria është zëvendësuar në mënyrë të gabuar. Zëvendësoni vetëm me të njëjtin tip ose me tip ekuivalent.

Informacion lidhur me temperaturat dhe lagështinë gjatë përdorimit dhe ruajtjes

- Përdoreni në një vend ku temperatura është ndërmjet 0°C (32°F) dhe 45°C (113°F) (deri në 90% lagështi relative).
- Mbajeni në një vend ku temperatura është ndërmjet -25°C (-13°F) dhe 55°C (131°F) (deri në 50% lagështi relative).
- Jetëgjatësia e baterisë mund të jetë më e shkurtër në kushte temperature të lartë ose të ulët.

## 2 Kufja juaj me Bluetooth




Udhëzues i shpejtë


Urime për blerjen tuaj dhe mirë se vini në Philips! Për të përfutur plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistrojeni produktin në [www.philips.com/welcome](http://www.philips.com/welcome). Me këtë kufje Philips me valë, ju mund të:

- bëni telefonata me valë pa përdorur duart;
- të dëgjoni dhe kontrolloni muzikë pa tel;
- të ndërroni nga telefonata në muzikë.

### Çfarë ka në kuti



Kufje fëmijësh Philips me valë (TAKH402)




Kablo karikimi USB (vetëm për karikim)

### Pajisje të tjera

Një celular ose pajisje portative (p.sh. Notebook, PDA, adaptorë Bluetooth, aparate MP3, etj.) që mbështet Bluetooth dhe është i pajtueshëm me kufjen (shiko "Të dhëna teknike" në faqen 8).

### Përmbledhje për kufjet tuaja me Bluetooth



- ① + Butoni i kontrollit të volumit
- ② Butoni i kontrollit të modalitetit të dritës
- ③ - Butoni i kontrollit të volumit
- ④ Vendi i karikimit micro USB
- ⑤ Butoni i ndezjes/fikjes
- ⑥ Treguesi LED
- ⑦ Mikrofoli

# 3 Fillimi

## Karikoni baterinë

### Shënim

- Para se t'i përdorni kufjet për herë të parë, karikoni baterinë për 5 orë me qëllim që bateria të ketë kapacitet dhe jetëgjatësi optimale.
- Përdorni vetëm kabllon USB të karikimit origjinalë për të shmangur ndonjë dëmtim.
- Mbaroni telefonatën para se të karikoni kufjet, pasi lidhja e kufjeve do t'i fikë ato.
- Mund t'i përdorni kufjet normalisht gjatë karikimit.

Lidhni kabllon USB të karikimit të përfshirë në:


- vendin e karikimit micro USB në kufje, dhe;
  - portën e karikimit/USB-së në një kompjuter.
- ↳ Drita LED ndizet në ngjyrë të bardhë gjatë karikimit dhe fiket kur kufjet janë të karikuara plotësisht

### Këshillë

- Normalisht, karikimi i plotë zgjat 2 orë.

## Çiftoni kufjet me telefonin tuaj celular

Para se të përdorni kufjet me telefonin celular për herë të parë, çiftojeni me një telefon celular. Një çiftim i suksesshëm vendos një lidhje unike të koduar midis kufjeve dhe telefonit celular. Kufjet ruajnë 8 pajisjet e fundit në memorie. Nëse përpiqeni të çiftoni me shumë se 8 pajisje, pajisja e çiftuar më e para zëvendësohet me të rene.

- 1 Sigurohuni që kufjet janë karikuar plotësisht.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur butonin  për 2 sekonda për t'i nderur kufjet.
- 3 Sigurohuni që celulari të jetë i nderur dhe që të jetë aktivizuar veçoria Bluetooth.
- 4 Çiftoni kufjet me telefonin celular. Për informacione të detajuara, shikoni manualin e përdorimit të telefonit tuaj celular.

Shembulli i mëposhtëm ju tregon se si t'i çiftoni kufjet me telefonin celular.

- 1 Aktivizoni veçorinë Bluetooth të celularit tuaj, zgjidhni Philips KH402.
- 2 Formoni fjalëkalimin e kufjeve "0000" (4 zero) nëse kërkohet. Për telefonat celularë me Bluetooth 3.0 ose më të lartë, nuk ka nevojë të vendosni një fjalëkalim.



Philips KH402

# 4 Përdorimi i kufjeve

## Lidhja e kufjeve me një pajisje me Bluetooth

- 1 Ndizni telefon celular/pajisjen Bluetooth.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur butonin   për 3 sekonda për t'i ndezur kufjet.
  - ↳ Drita blu ndizet.
  - ↳ Kufjet lidhen përsëri automatikisht me telefonin celular/pajisjen Bluetooth që ishte lidhur për herë të fundit. Nëse kufjet nuk mund të lidhen me pajisjen e fundit brenda 13s, ato do të hyjnë në modalitetin e çiftimit.



### Këshillë

- Nëse e ndizni telefonin celular/pajisjen me Bluetooth ose aktivizoni Bluetooth pasi keni ndezur kufjet, duhet t'i lidhni përsëri manualisht kufjet dhe telefonin celular/pajisjen me Bluetooth.



### Shënim

- Nëse kufjet nuk lidhen me asnjë pajisje Bluetooth për 5 minuta, ato do të fiken automatikisht për të kursyer baterinë.

## Menaxhoni telefonatat dhe muzikën

### Ndezur/fikur

Detyra	Butoni	Funksionimi
Ndizni kufjet.	�	Shtyp dhe mbaj për 2 sekonda.
Fikini kufjet.	�	Shtyp dhe mbaj për 3 sekonda. ↳ Drita e bardhë ndizet dhe zbehet.

### Kontrolli i muzikës

Detyra	Butoni	Funksionimi
Luani ose ndaloni muzikën	�	Shtyp njëherë.
Rregullo volumnin.	+/-	Shtyp njëherë.






Kapërce përpara.	+	Mbah shtypur 1 sekondë.
Kapërce mbrapa.	-	Mbah shtypur 1 sekondë.

### Kontrolli i telefonatës

Detyra	Butoni	Funksionimi
Përgjigjuni/mbyl- leni një telefonatë.	�	Shtyp njëherë.
Refuzo një telefonatë hyrëse.	�	Mbah shtypur 1 sekondë.
Bëj përsëri telefonatën e fundit	�	Klikim dy herë

Heshtni/hapni mikrofonin në një telefonatë.		Klikim dy herë
---	---	----------------

#### Treguesi i modalitetit të dritës RGB


Detyra	Butoni	Funksionimi
Modaliteti i dritës së kuqe		Shtyp njëherë.
Modaliteti i dritës jeshile		Shtyp njëherë.
Modaliteti i dritës blu		Shtyp njëherë.
Modaliteti i dritës së ylberit		Shtyp njëherë.
Drita fikur		Shtyp njëherë.

#### Statusi i treguesit të kufjeve të tjera

Statusi i kufjeve	Treguesi
Kufjet janë të lidhura me një pajisje Bluetooth, ndërsa kufjet janë në gjendje pritjeje ose ndërsa dëgjoni muzikë	Drita LED blu pulson çdo 5 sekonda.
Kufjet janë gati për çiftim.	Drita LED pulson ngjyrë blu dhe të bardhë me radhë.
Kufjet janë të ndezura por jo të lidhura me një pajisje Bluetooth.	Drita LED pulson në ngjyrë blu dhe të bardhë me radhë. Kufjet do të fiket brenda 5 minutash.
Nivel i ulët i baterisë.	Drita LED e bardhë pulson 3 herë çdo 1 minutë derisa të fiket automatikisht.
Bateria është karikuar plotësisht.	Drita fikur.

## Vendosja e kufjeve

Rregulloni rripin sipas kokës.



# 5 Të dhënat teknike

- Koha e muzikës: 20 orë
- Koha e bisedës: 20 orë
- Koha në gatishmëri: 800 orë
- Koha normale për një karikim të plotë: 2 orë
- Bateria e karikueshme me polimere litiumi (200 mAh)
- Mbështetje Bluetooth 5.0 (Hands-Free Profile - HFP), mbështetje Bluetooth stereo (Advanced Audio Distribution Profile - A2DP; Audio Video Remote Control Profile - AVRCP)
- Diapazoni i frekuencave: 2.402-2.480GHz
- Fuqia e transmetuesit: < 4dBm
- Gama e funksionimit: Deri në 10 metra (33 këmbë)
- Reduktim i ekos dhe zhurmës dixhitale për qartësi telefonate
- Fije automatike e rrymës



## Shënim

- Specifikimet janë objekt ndryshimi pa njoftim.
- Bateritë e karikueshme mund të karikohen vetëm nën mbikëqyerjen e të rriturve.



# 6 Njoftim

## Deklarata e përputhshmërisë

Me anë të kësaj, MMD Hong Kong Holding Limited deklaron se ky produkt është në përputhshmëri me kërkesat thelbësore dhe dispozita të tjera relevante të Direktivës 2014/53/BE. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në [www.p4c.philips.com](http://www.p4c.philips.com).

## Asgjësimi i produktit dhe baterisë së vjetër



Produkti juaj është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol mbi produktin do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/BE.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban një bateri të integruar të rikarikueshme të mbuluar nga Direktiva Evropiane 2013/56/BE, e cila nuk mund të asgjësohet me mbetje normale shtëpiake. Ne ju këshillojmë fort që të dërgoni produktin në një pikë zyrtare grumbullimi ose të një qendër servisi Philips që bateria e rikarikueshme të hiqet nga një profesionit. Informohuni për sistemin lokal të ndarë për produkte elektrike ose elektronike dhe bateri të rikarikueshme. Ndiqni rregullat lokale dhe mos e asgjësoni asnjëherë produktin dhe bateritë e rikarikueshme me

mbetjet normale shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra dhe baterive të karikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.


## Hiqni baterinë e integruar



### Shënim

- Sigurohuni që kufjet janë të shkëputura nga kabli i karikimit USB para se ta hiqni baterinë.

Nëse nuk ka sistem grumbullim- i/riciklimi për produkte elektronike në vendin tuaj, ju mund të mbron mjedisin duke hequr dhe ricikluar baterinë para se të asgjësoni kufjet.



## Përputhshmëria me EMF-në

Ky produkt përputhet me të gjithë standardet dhe rregulloret e zbatueshme në lidhje me ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

**Informacion për mjedisin.** Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin të lehtë për t'u ndarë në tre materiale: karton (kutia), shumë polisteroli (amortizatori) dhe polietilen (qeset, fleta e shumës mbrojtëse.)

Sistemi juaj përbëhet nga materiale që mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju luemi ndiqni rregullat lokale lidhur me hedhjen

e materialeve të paketimit, baterive të shkarkuara dhe pajisjeve të vjetra.

## Markat tregtare

### Bluetooth

Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë.

## Njoftimi i përputhshmërisë

Pajisja përputhet me rregullat FCC, pjesa 15. Përdorimi është objekt i dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, përfshirë interferencën që mund të shkaktojë përdorim të padëshiruar.

### Rregullat FCC

Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje dixhitale të Klasit B, sipas pikës 15 të rregullave FCC. Këta kufij janë vendosur për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencës së dëmshme në një instalim rezidencial. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencës radio dhe, nëse nuk është instaluar dhe përdorur në përputhje me manualin e udhëzimit, mund të shkaktojë interferencë të dëmshme ndaj komunikimeve radio.

Sidoqoftë, nuk ka garanci që interferenca nuk do të ndodhë në një instalim të veçantë. Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë që mund të përcaktohet duke e fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi nxitet që të përpiqet ta korrigjojë interferencën duke ndjekur një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Zhvendosni antenën marrëse.
- Rritni hapësirën mes pajisjes dhe marrësit.
- Lidhni pajisjen në një prizë që ndodhet në një qark të ndryshëm nga ai në të cilin është lidhur marrësi.
- Konsultoni shitësin ose një teknik radio/TV me eksperiencë për ndihmë.

### Deklarata e ekspozimit të rrezatimit FCC:

Pajisja përputhet me kufijtë FCC e ekspozimit ndaj rrezatimit të Kanadasë të përcaktuar për mjediset e pakontrolluara. Ky transmetues nuk mund të bashkë-vendoset ose përdoret së bashku me një antenë ose transmetues tjetër.

### Deklarata për pajtueshmërinë FCC:

Ndryshimet ose modifikimet që nuk janë miratuar shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.

Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje dixhitale të Klasit B, sipas pikës 15 të rregullave FCC. Këta kufij janë vendosur për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencës së dëmshme në një instalim rezidencial. Pajisja gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencave radio dhe, nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret sipas udhëzimeve, mund të shkaktojë interferenca të dëmshme ndaj komunikimeve radio. Sidoqoftë, nuk ka garanci që interferenca nuk do të ndodhë në një instalim të veçantë.

Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë që mund të përcaktohet duke e fikur dhe nderur pajisjen, përdoruesi nxitet që të përpiqet ta korrigjojë interferencën duke ndjekur një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Ndryshoni orientimin ose lëvizeni antenën.
- Largoni distancën mes pajisjes dhe marrësit.
- Lidhni pajisjen në një prizë që ndodhet në një qark të ndryshëm nga ai në të cilin është lidhur marrësi.
- Konsultoni shitësin ose një teknik radio/TV me eksperiencë për ndihmë.

#### IDeklarata për pajtueshmërinë SED:

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës të përjashtuar nga licencat të cilat i përmbahen RSS-ve të Inovacionit, Shkencës dhe Zhvillimit Ekonomik të Kanadasë të përjashtuar nga licencat. Përdorimi është objekt i dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferenca.
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interference, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë punim të padëshiruar të pajisjes.

#### Deklarata për pajtueshmërinë me ekspozimin RF:

Kjo pajisje përputhet me kufijtë FCC/IC e ekspozimit ndaj rrezatimit të Kanadasë të përcaktuar për mjediset e pakontrolluara. Ky transmetues nuk duhet të vendoset së bashku me një antenë ose transmetues tjetër ose të punojë së bashku me to.

**Kujdes:** Përdoruesit i tërhiqet vëmendja se ndryshimet ose modifikimet e pa miratuara shprehimisht nga pala përgjegjëse për përputhshmërinë mund ta bëjnë nul autoritetin e përdoruesit për të përdorur pajisjen.

# 7 Pyetjet më të shpeshta

Kufjet e mia me Bluetooth nuk ndizen. Niveli i baterisë është i ulët. Karikoni kufjet.

Nuk mund t'i lidh kufjet me një telefon celular.

Bluetooth-i është çaktivuar. Aktivizoni veçorinë Bluetooth në celularin tuaj dhe ndizni celularin para t'i ndizni kufjet.

Çiftimi nuk punon.

Sigurohuni që kufjet janë në modalitetin e çiftimit.

- Ndiqni hapat që tregohen në këtë manual përdorimi (shikoni "Çiftojini kufjet me telefonin celular" në faqen 4).
- Sigurohuni që drita LED pulson në ngjyrë blu dhe të bardhë me radhë

Telefoni celular nuk i gjen dot kufjet.

- Kufjet mund të jenë lidhur me një pajisje të çiftuar më parë. Fikni pajisjen e lidhur ose nxirreni jashtë fushës.
- Çiftimi mund të jetë fshirë ose kufjet janë çiftuar më parë me një pajisje tjetër. Çiftojini kufjet me telefonin celular përsëri siç tregohet në manualin e përdorimit (shiko "Çiftimi i kufjeve me telefonin celular" në faqen 4).

Kufjet e mia me Bluetooth janë lidhur me një telefon celular me Bluetooth stereo, por muzika luhet vetëm në boksën e celularit tim.

Referojuni manualit të përdorimit të telefonit tuaj celular. Zgjidhni të dëgjoni muzikë përmes kufjeve.

Cilësia audio është e varfër dhe mund të dëgjohet zhurmë e çjerrë.

Pajisja Bluetooth është jashtë rrezes.

Afroni kufjet dhe pajisjen Bluetooth, ose largoni pengesat mes tyre.

Cilësia audio është e dobët kur transmetimi nga celulari është shumë i ngadaltë, ose transmetimi audio nuk punon fare.

Sigurohuni që celulari juaj mbështet jo vetëm (mono) HFP por edhe A2DP (shiko të "Të dhëna teknike" në faqen 7).

Unë dëgjoj por nuk të kontrolloj muzikën në pajisjen time Bluetooth (p.sh. luaj/n-dalo/kalo përpara/mbrapa).

Sigurohuni që burimi audio i Bluetooth mbështet AVRCP (shih "Të dhënat teknike" në faqen 7).

Për ndihmë të mëtejshme, vizitoni [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support).



Este equipamento não tem direito à proteção contra Interferência prejudicial e não pode causar interferência em sistemas devidamente autorizados. Este produto está homologado pela ANATEL de acordo com os procedimentos regulamentados pela Resolução 242/2000, e atende aos requisitos técnicos aplicados. Para maiores informações, consulte o site da ANATEL: [www.anatel.gov.br](http://www.anatel.gov.br)

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

UM\_TAKH402\_00\_EN\_V1.0  
WK1921

